Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 26/17
Datë/Datum. 06.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza lidhur me Ankesën Nr. **26/16** e OE **"El-Bau"** - Gjilan.		
Datë:	06.02.2017		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar me dt: 23.01.2016 me Nr. **26/17** nga OE **"El-Bau"** - Gjilan, për shqyrtimin e lëndës "Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në territorin e Komunës së Vitisë" me numër të prokurimit: VI657/17/070/221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Vitisë (KV).

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KOMUNA E VITISË.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – EL-BAU.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		26.01.2017		**26.01.2017**		**06.02.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 23.01.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 26/16 e parashtruar nga OE **"El-Bau",** me seli në Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në territorin e Komunës së Vitisë"** me numër të prokurimit: VI657/17/070/221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna e Vitisë (KV).**
Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komunës së Vitisë (KV).**

N.111 i LPP-së - Operatori Ekonomik Ankues "El-Bau", me seli në Gjilan.

Pikat e Ankesës nga OE **"El-Bau"** *- dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 1 - Qëllimi;
Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 23 – Zyrtaret e prokurimit;
Neni 56 - Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave;
Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
Neni 60 – Kriteret për dhënie të kontratës;
Neni 130 – Ndikimi i Paligjshëm;
Kodi etik i Prokurimit, neni 3,4,6,7;
Neni 84 i Ligjit per Procedur Administrative.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Përshkrimi i rrethanave faktike

1. Operatori Ekonomik OE "EL-BAU" ka marrë pjesë në këtë tender si grup së bashku me kompaninë "GLOBAL PROJEKT" dhe sipas Marrëveshjes për bashkpunim e datës 23.12.2016, deklaratës mbi autorizimin e datës 23.12.2016, Pjesa C - Formulari i dorëzimit të tenderit, lider/udhëheqës i autorizuar për të vepruar në emër të grupit dhe për të nënshkruar këtë tender në emer të konzorciumit është kompania "ELBAU" Sh.p.k. nga Gjilani. Bazuar në procesverbalin e hapjes së tenderëve gjatë seancës së mbajtur nga AK për hapjen e tenderëve vërtetohet se për këtë aktivitet ofertat e tyre kanë dorëzuar operatorët ekonomik:

	Tenderuesi	Vendi	Çmimi i përgjithshëm
1	El-Bau & Global	Gjilan	52,852.50 €
2	Zuka COmerce	Gjilan	68,271.50 €

Provë: Marrëveshja e bashkëpunimit e lidhur në mes OE "El-Bau" dhe OE "Global Projekt" me të gjitha shtojcat tjera, dt.23.12.2016 Procesverbali i hapjes se ofertave

2. Me datën jemi kontaktuar nga një person me të cilin kemi bashkpunuar në implementimin e një projekti në Komunën e Vitisë (identitetin e tij do ta zbulojmë nëse na kërkohet mirëpo me kusht që të sigurohet mbrojtja e tij) i cili na ka njoftuar se Fadil Abazi duke ditur raportin e tij me neve e ka dërguar të na kërkojë që medeomos duhet ta tërheqim ofertën e dorëzuar për këtë aktivitet prokurimi madje duke na premtuar edhe një shumë të caktuar të mjeteve. Personin në fjalë iu është bërë me dije se OE "El-Bau" për këtë aktivitet prokurimi ka dorëzuar ofertën me çmim më të lirë (52,852.50€) se sa konkurrenti i vetëm OE "Zuka Company" (68.271.50€) dhe se i plotësojnë të gjitha kushtet siç janë kërkuar në dosje të tenderitandaj edhe e kemi njoftu se nuk mund të tërheqim dosjen e tenderit. Ai ka insistuar me çdo kusht të na bindë të tërhiqemi pasi në bazë të fjalëve të tij Fadil Abazi i ka thënë se e ka pre në besë për faktin që nuk na ka bindë të mos konkurojmë fare për këtë tender dhe duhet të na bindë tani ta tërheqim dosjen e tenderit.

3. Duke pasur parasysh rastin konkret si dhe eksperiencën në të kaluarën me problemet që jemi ballafaquar nga i njejti dhe pikërisht kur ka qenë në pyetje kompania "Zuka Comerce" dhe kompania Vision Projekt (të cilën e ka shpallur fitues në disa projekte edhe përkundër faktit se ka pas njohuri se kjo kompani kishte falsifikuar vërtetimin e ATK-se) kemi parashikuar se i njejti do të përdor çdo mjet të mundshëm në kundërshtim me parimet bazike të udhëheqjes së procedurës së vlerësimit për të nxjerrë një vendim që kontrata t'i jepet OE të parapëlqyer "Zuka Company" dhe për të përjashtuar nga konkurenca OE "El-Bau", andaj duke pasur parasysh këtë situatë me datën 27.12.2016 me një parashtresë elektronike kemi njoftuar KRPP, Agjencionin Antikorrupsion, etj nga të cilët kemi kërkuar që të monitorohet udhëheqja e procedurës së vlerësimit lidhur me këtë aktivitet.

Provë: Kërkesa për monitorim të vlerësimit të prokurimit,dt.27.12.16

4. Ashtu siç edhe kishim parashikuar me kohë se ekziston dyshim i bazum se Fadil Abazi do të ndërmarrë çfarëdo mase dhe përdor çfarëdo mjeti me qëllim që të ndikojë vlerësimin e drejtë dhe të ligjshëm që kontrata t'i jepet OE të parapëlqyer "Zuka Company" dhe për të përjashtuar nga konkurenca OE "El-Bau", me datën 04.01.2017 përmes emailit nga z. Fadil Abazi kemi pranuar njoftimin "Ju njoftojmë me ketë shkrese te pertnerit tuaj,te pranuar me date 30.12.2016" dhe në attachment kishte bashkangjitur një shkresë në emër të OE "Global Projekt" e emërtuar "Njoftim për tërheqje" e adresuar për Komunën e Vitisë dhe e protokolluar me Nr. 02016/49588 dt. Prot. 30.12.2016.

Provë: Njoftimi përmes emailit nga Fadil Abazi dhe ne attach shkresa "Njoftim për tërheqje" Nr. prot. 02016/49583, dt prot30.12.2016

5. Pas marrjes së kësaj shkrese duke pasur parasysh se bashkpunimin me OE "Global Projekt" e kemi bërë me vullnet të lirë të dyanshëm dhe se pjesëmarrësit janë marrë vesh për elementet thelbësore të marrëveshjes dhe kanë për detyrë dhe përgjegjësi ta përmbushin detyrimin, se në qoftë se pas lidhjes së kontratës krijohen rrethana që e vështirësojnë përmbushjen e detyrimit nga njëra palë, ajo palë duhet të kërkojë nga pala tjetër që kontrata të zgjidhet apo të ndryshohet me anë të negocimit në mes palëve në mënyrë paqësore pasi pala me këtë rast nuk ka mundur të thirret në rrethana të ndryshuara pasi ka pasur për detyrë që në kohën e lidhjes së kontratës të marrë në konsiderim këto rrethana ose ka mundur që këto t'i evitojë apo t'i përballojë, me datën 05.01.2017 e kemi zhvilluar një takim me Musli Zubakun pronar i kompanisë "Global Projekt". Nga i njejti jemi njoftuar se dikush i ka kërkuar vëllaut të tij me u tërheq nga konzorciumi dhe ka pas kërkesa të vazhdueshme nga vëllai i tij për tu tërheq nga konzorciumi dhe në rast se nuk do të tërhiqej vëllau i tij i kishte bërë me dije se do të prisheshin marrëdhëniet famljare në mes tyre dhe se për këtë shkak duke mos pasur mundësi tjera dhe mos të krijojë konflikt familjar me vllaun ishte detyruar që të tërhiqet nga konzorciumi dhe për ta shkruar shkresën e kishte gjetur një person (herë ka thënë një zyrtarë komune e herë avokat) që ja ka shkru deklaratën të cilën edhe na është dërguar me datën 04.01.2017 nga Fadil Abazi. Sipas informacioneve tona të paverifikuara këtë shkresë e ka shënuar zyrtari i komunës së Kamenicës z. Hasan Keqmezi i cili më parë ishte menagjer i prokurimit andaj vëmë në pah dyshimin se ka gjasa që ky të jetë personi ndërmjetësues në mes menagjerit të Komunës së Vitisë z. Fadil Abazi dhe vëllaut apo pronarit të kompanisë "Global Projekt" z. Musli Zubaku Kërkojmë nga OSHP që në

zbatim të drejtë dhe të ligjshëm të kësaj procedure gjatë shqyrtimit fillestar dhe procedurave të vendimmarrjes të marr në pyetje dëshmitarin dhe njëherit pronarin e kompanisë "Global Projekt z. Musli Zubaku apo nëse verifikon informatën edhe z. Hasan Keqmezi

6. Me datën 01.05.2017 lidhur informacionet e pranuara, deklaratës së OE "Global Projekt" për tërheqje nga konzorciumi për të cilën jemi njoftuar nga z. Fadil Abazi me datën 04.01.2017, informative të siguruara nga takimi me pronarin e kompanisë "Global Projekt" z. Musli Zubaku, të njejtat ju kemi dërguar KRPP-së, AKK-së si dhe një pjese të deputevë të Kosovës nga Komisioni për Mbikqyrje Financiare nga të cilët (KRPP dhe AKK) me datën 27.12.2017 patëm kërkuar monitorimin e vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit.

Provë: Njoftimi përmes emailit KRPP, AKK dhe disa deputetë, dt. 05.01.2017

7. Gjithashtu me datën 05.01.2017 pas pranimit të informacioneve nga z. Fadil Abazi lidhur me deklaratën e OE "Global Projekt" për tërheqje nga konzorciumi, informative të siguruara nga takimi me pronarin e kompanisë "Global Projekt" z. Musli Zubaku, një shkresë e kemi adresuar në drejtim të Fadil Abazit të cilin e kemi vënë në dijeni se të gjitha këto veprime janë të orkestruara dhe manipuluara nga ai për interesa të tij personale të korrupsionit që përmes lidhjeve të ndryshme me qëllim që të ndikojë në zbatimin e drejtë dhe të ligjshëm të vlerësimit të këtij aktiviteti prokurimi që kontrata t'i jepet OE të parapëlqyer "Zuka Company" dhe të përjashtohet nga konkurenca OE "El-Bau" ashtu siç edhe ka ndodhur. Po ashtu të njejtin e kemi vënë në pah se përveq se dyshohet se deklarata është e ndikuar dhe manipuluar jashtë vullnetit të pronarit të kompanisë "Global Projekt" pasi e njejta është në kundërthënie me vetë autorizimin e dhënë me datën 23.12.2016 nga pronari i OE "Global Projekt" Musli Zubaku në të cilin ka deklaruar me vullnet të lirë se" Si partner i konzorciumit për tenderin me titull: Mirmbajtja verore dhe dimrore në territorin e komunës së Vitisë me Nr. Prok. VI 657 16 070 221 Deklarojmë se autorizojmë kompaninë EL BAU sh.p.k., Lider në këtë projekt, si dhe për të vepruar në emer të frupit. Gjithashtu në Pjesën C - Formulari i dorëzimit të tenderit, anëtari i konzorciumit "GLOBAL PROJEKT" është pajtuar dhe ka autorizuar që lider/udhëheqës i autorizuar për të vepruar në emër të grupit dhe për të nënshkruar këtë tender në emer të konzorciumit është kompania "EL-BAU" Sh.p.k. nga Gjilani. Ndërsa Marrëveshja për Bashkpunim në mes partnerit udhëheqës - Lideri "EL-BAU" sh.p.k dhe partnerit të grupit N.N.T. "GLOBAL PROJEKT" e nënshkruar nga personi i autorizuar nga OE "EL-BAU" dhe në emër të OE "GLOBAL PROJEKT" nga pronari i saj Musli Zubaku, në nenin 16 tekstualisht parasheh se marrveshja ndërprehet si e pavlefshme në këto raste: Në rast se oferta e përbashkët ër këtë projekt nuk Zaidhet si më ërshtatshmja nga autoriteti kontraktues; Në rast Se ftesa për tender të anulohet nga autoriteti kontraktues. Në rast se likuidimi Ose cila do palë gjendet nën autoritetin gjyqësor Si e ndjekur para nënshkrimit të kontratës.

Provë: Njoftimi përmes emailit për Fadil Abazin, dt. 05.01.2017

8. Me datë 06.01.2017 nga z. Fadil Abazi përmes emailit në attachment kemi pranuar Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, "El-Bau&Global Projekt", në të cilën është shënuar se jemi eliminuar për shkak se nuk kemi dorëzuar tender të përgjegjshëm për arsyet si në vijim:

9. Nuk keni plotesua kriterin ne FDT pika 11.1; Jeni i papergjegjshem sipas Njoftimit te dates

30.12.2016, ku kemi terheqjen e partnerit te Konzorciumit,

10. Kemi pranuar nje Leter terheqje nga GLOBAL PROJEKT, me daten 30.12.2016, sipas te

cilet konzorciumi juaj me kete OE eshte i pavlefshem

11. Me datën 10.01.2017 kundër vendimit Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, "El-Bau&Global Projekt" të dt. 06.01.2017 kemi parashtruar Kërkesën për Rishqyrtim duke e mbështetur në gjendjen faktike të përshkruar deri më tani që sipas këndvështrimit tonë ashtu siç kishim parashikuar procesi i përgjithshëm i administrimit të këtij prokurimi duke filluar nga hapja e tenderit dhe paraqitja e ofertave nga dy OE pjesëmarrës (ankuesi dhe OE "Zuka Company") ciklin e vlerësimit të ofertave dhe nxjerrja e të gjitha vendimeve të deritanishme është bërë me veprime manipuluese në kundërshtim të plotë me parimet bazike të prokurimit, dispozitat e përgjithshme mbi

përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave si dhe në mënyrë të pandershme, pandërgjegjshme,joprofesionale siç i udhëzon Kodi Etik i Prokurimit i manipuluar.

Provë: Kërkesa për Rishqyrtim

12. Me datën 17.01.2017 nga Fadil Abazi përmes emailit në attach kemi pranuar Vendimin Nr. 02-13/30 i dt. 13.01.2017 mbi Refuzimin si të pabazuar të ankesës së OE "El-Bau", pranuar përmes emailit (attachment) me dt. 13.01.2017 nga Menagjeri i Zyrës së Prokurimit Fadil Abazi. Vetë përmbajtja e arsyetimit të vendimit, shprehjet e tij me një fjalor banal dhe larg etikës dhe profesionalizmit është pasqyra më e mirë që tregon nivelin dhe integritetin e karakterit personal dhe professional të këtij personi të cilit një institucion i ka besuar udhëheqjen dhe shpenzimin me fonde publike.

Provë: Vendimi Nr. 02-13/30 i dt. 13.01.2017

Përshkrimi në kontekst të gjendjes faktike që përbëjnë pretendimin për shkelje të dispozitave të LPP-së, rregullave të prokurimit publik dhe ligjeve tjera

13. Përtej fakteve të përshkruara më lartë që në rast se arrihet të vertetohen nga nga OSHP gjatë shqyrtimit të këtij rasti, në lidhje me terheqjen e partnerit konsiderojmë që nga kontrata që ishte lidhur në mes palëve ishin përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe qështja e shkeputjes së kontrates, ndër të cilat kushte nga partneri nuk ishte përmbushur dhe deklarata e dhënë nuk ishte bërë në bazë të kontratës dhe autorizimit për përfaqësim. Formulari i dorëzimit të tenderit, anëtari i konzorciumit "GLOBAL PROJEKT" është pajtuar dhe ka autorizuar që lider/udhëheqës i autorizuar për të vepruar në emër të grupit dhe për të nënshkruar këtë tender në emer të konzorciumit është kompania "EL-BAU" Sh.p.k. nga Gjilani. Kësisoji nga autoriteti kontraktues në mënyrë të gabuar është bërë pranimi dhe interpretimi i deklaratës lëndore sepse përmes së ciles nuk ka mundur të bëhet shkëputja e kontrates dhe në kundërshtim me LMD neni 2, 4, 5, 6, 8, 9, 11, 15, 25, 72, 74, 116.2,136,137,169 dhe neni 987-999.

14. Në këtë drejtim duke pasur parasysh mënyrën dhe periudhën kohën kur shkruar deklarata, njëanshmëria e deklaratës pa e njoftuar liderin e konzorciumit, pasi që anëtari i konzorciumit nuk ka mundur të thirret në këto rrethana ngase i njejti ka pasur për detyrë që në kohën e lidhjes së kontratës të marrë në konsiderim këto rrethana ose ka mundur që këto t`i evitojë apo t`i përballojë, tregimin sipas verzionit të pronarit të kompanisë Musli Zubaku se si vëllau i tij i ka vënë kusht për shkëputjen e marrëveshjes për konzorcium për arsyet e sipërcekura, faktin se dyshohet se ky teksti deklaratës është shënuar nën ndikimin dhe kontrollin e Fadil Abazit siç rrëfen z. Zubaku se është shkruarnga një zyrtar i komunës që ne dyshojmë se ka gjasa të jetë z. Hasan Keqmezi i cili mban lidhje me Fadil Abazin, krejt këto veprime të orkestruara nga Fadil Abazi janë bërë si e vetmja mundësi me eliminu ofertën e OE "EL-Bau" e cila ishte me çmim më të lirë q të sigurojë rrethana që kontrata t'i jepet OE të parapëlqyer "Zuka Company". Andaj ky vendim përbën vendim të padrejtë dhe të paligjshëm dhe si i tillë duhet të shpallet NULL pasi pasoja e shkaktuar dhe ekzekutimi i tij shkakton vepër penale të denueshme sipas nenit 130 të LPP-së lidhur me ligjin penal.

15. Andaj në kontekst të gjendjes faktike dhe bazës ligjore gjatë fazës së shqyrtimit të prokurimit po të zbatohej procesi i vlerësimit bazuar në parimet kryesore të prokurimit, konkurencës, efikasitetit&efektivitetit, drejtësisë/mosdiskriminimit, kushteve të barabarta në mënyrë të drejtë dhe me qëllim të zgjidhjes së drejtë dhe të ligjshme, oferta e OE "El-Bau&Vemor" do të ekzistonin gjasat serioze të vlerësohej tender i përgjegjshëm në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosjes së tenderit, dhe sipas kriterit për dhënien e kontratës të shpallet fitues si tenderi i përgjegjshëm me çmim më të lirë.Si rezultat rrethanave faktike të cilat i konstatuam më lartë konsiderojmë se eliminimi nga pjesëmarrja e mëtutjeshme për aktivitetin e prokurimit në fjalë është bërë vetëm me shkak të trajtimit jo të barabartë/diskriminimit në raport me operatorin ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës dhe në këtë kontekst mendojmë të ketë shkelje serioze e LPP nr.04/L-042, rregullave të prokurimit në Kosovë me dashje nga menagjeri i prokurimit Fadil Abazi, dhe atë të dispozitave si në vijim:

Neni 1 paragrafi 1,2 dhe 3 i Ligjit të Konsoliduar Nr.04/L-042, Qëllimi;

16. Zyrtari i përgjegjës i prokurimit z. Fadil Abazi gjatë administrimit të vlerësimit të prokurimit në këtë lëndë për asryet që u konstatuan më lartë nuk ka vepruar siç e obligon neni 1 i këtij ligji i cili si qëllim ka që të sigurohet mënyrën më efikase më transparente dhe më të drejtë të fondeve publike, sigurimin e integritetit dhe përgjegjësinë e zyrtarëve të prokurimit duke kërkuar që vendimet e tyre të jenë në pajtim me bazën ligjore dhe faktike dhe mos të ndikohen nga interesat personale, materiale por të karakterizohen me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës, me një kulturë institucionale dhe profesionale, të pandikuar, të paanshme, etike dhe duke ju përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Neni 6 paragrafi 1 i Ligjit të Konsoliduar Nr.04/L-042, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

17. Zyrtari i përgjegjës i prokurimit z. Fadil Abazi gjatë administrimit të vlerësimit të prokurimit në këtë lëndë për asryet që u konstatuan më lartë nuk ka vepruar siç e obligon neni 6.1 i këtij ligji të sigurojë që fondet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, për shkak se i ndikuar nga interesat personale apo interesa tjera për dobi financiare për veten apo organizatën biznesore "Zuka Comerce" në kundërshtim me këtë ligj për të ndikuar në rezultatin e vendimit që me qdo kusht të gjindet një arsye për eliminim të OE EL-BAU, përmes komunikimeve të paautorizuara dhe negociatave në mënyrë direkte apo indirekte përmes njërzve të ndryshëm ka ndikuar në vullnetin e anëtarit të konzorciumit GLOBAL PROJEKT që të bëjë një deklaratë për tërheqje nga konzorciumi me qëllim të favorizimit dhe dhënies së kontratës OE "Zuka Company"

Neni 7 paragrafi 1,2 dhe 4 i Ligjit të Konsoliduar Nr.04/L-042, Barazia në Trajtim/ Jo Diskrimimim;

18. Zyrtari i përgjegjës i prokurimit z. Fadil Abazi gjatë administrimit të vlerësimit të prokurimit në këtë lëndë për asryet që u konstatuan më lartë nuk ka vepruar sipas asnjërit paragraf të kësaj dispozite të prokurimit që përcakton barazinë në trajtim dhe jo-diskriminim që është edhe parim bazik i prokurimit. I njejti përmes veprimeve të padrejta dhe të paligjshme ka krijuar rrethana imponuese që kanë rezultuar në trajtim të pabarabartë, jotransparente, rrethana që redukton dhe eliminon konkurencën e drejtë në mes OE pjesëmarrës për shkak të kushteve të krijuara nga të cilat diskriminohet në dëm të aspektit material dhe personal OE ELBAU dhe favorizohet përhapjen e rrugës për fitimin e kontratës OE "Zuka Company"

Neni 23 paragrafi 4 i Ligjit të Konsoliduar Nr.04/L-042,Zyrtarët e Prokurimit;

19. Sipas nenit 23 paragrafi 4 zyrtari përgjegjës i prokurimit që shërben në emër të AK sipas këtij neni nga pika ii) do të ushtrojë aktivitetet e prokurimit të autoritetit kontraktues në mënyrë të ndershme dhe të ndërgjegjshme dhe në pajtim të plotë me këtë ligj, dhe sipas pikës (iii) menjëherë do të ushtrojë në mënyrë profesionale të gjitha detyrat tjera të përcaktuara në këtë ligj. Veprimet e zyrtarit përgjegjës të prokurimit z. Fadil Abazi të përshkruara më lartë nuk janë veprime në pajtim me këtë dispozitë ligjore dhe në pajtim me Kodin Etik të Prokurimit.

Neni 59 paragrafi 4 dhe 5 i Ligjit të Konsoliduar së Nr.04/L-042, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve dhe neni 60 paragrafi 1.1, Kriteret për dhënien e kontratës;

20. Konsiderojmë se OE "EL-BAU&GLOBAL PROJEKT" duke marrë pjesë në këtë tender si grup së bashku me kompaninë "GLOBAL PROJEKT" bazuar në Marrëveshjen për bashkpunim e datës 23.12.2016, deklaratës mbi autorizimin e datës 23.12.2016, Pjesa C - Formulari i dorëzimit të tenderit, lider/udhëheqës i autorizuar për të vepruar në emër të grupit dhe për të nënshkruar këtë tender në emer të konzorciumit është kompania "EL-BAU" Sh.p.k. nga Gjilani si dhe dëshmive tjera dokumentare duke përjashtuar rrethanat e krijuara nga veprimet e paligjshme të Fadil Abazit, ankuesi ka paraqitur tender të përgjegjshëm në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe bazuar në nenin 59.4 tenderi i dorëzuar nga ne është dashur që të vlerësohet si tender i përgjegjshëm. Gjithashtu pasur parasysh komunikimet e pauutorizuara dhe negociatat që zyrtari përgjegjës i prokurimit z. Fadil Abazi i ka zhvilluar me ndërmjetësues për të ndikuar në vullnetin e OE EL-BAU që të tërhiqet nga tenderi dhe ndikuar në vullnetin e lirë të OE GLOBAL PROJEKT për tu tërhequr nga konzorciumi paraqesin shkelje nga neni 59.5 të LPP-së

Nenin 130 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, 12.2,1.3 dhe 1.6 i Ligjit të konsoliduar 04/L- 042, Kriteret për dhënien e kontratës;

21. Zyrtari i përgjegjës i prokurimit z. Fadil Abazi gjatë administrimit të vlerësimit të prokurimit në këtë lëndë për asryet që u konstatuan më lartë ka kryer shkelje të cilat janë të dënushme dhe zbatueshme në pajtim me ligjin përkatës në fuqi dhe ligjin përkatës penal. Kurdo që materializohen faktet e paraqitura më lartë do të vërtetohet se zyrtari përgjegjës i prokurimit z. Fadil Abazi me qëllim të krijimit të kushteve për favorizim të OE "Zuka Company" me të cilin dyshojmë se ka lidhje ka zhvilluar negociata, marrëveshje, aranzhmane për të ndikuar plotësisht në vullnetin e lirë të anëtarit të konzorciumit OE GLOBAL PROJEKT, vullnetin e zyrtarëve të komisionit të vlerësimit që vendimi të ndikojë në parandalimin,kufizimin e konkurencës duke shkaktuar dëmtimit të interesit të OE EL-BAU dhe favorizimin për dhënie të kontratës OE "Zuka Company. Gjithashtu bazuar në paragrafin 1.6 të nenit 130 të LPP-së, personi apo personat që janë zyrtar të lartë, drejtor të ndërmarrjes që janë përfshirë në këto raste është dashur me qenë në dijeni sipas kujdesit të arsyeshëm për rastet e shkaktuara të një veprimi të tillë

Shkelje të Kodin Etik të Prokurimit dhe atë:

22. Neni 3 **(parimet)** paragrafi 3.4 dhe 3.5 - Është detyrë e zyrtarëve të prokurimit të promovoni vazhdimisht standardet më të larta në aspektin profesional, teknik,ligjor dhe të mbani nivel të padiskutueshëm të integritetit në të gjitha relacionet private dhe profesionale brenda dhe jashtë organizatës ku punoni.

23. Nenin 4 **(Udhëheqja)** paragrafi. 4.5 -Konkurenca e drejtë - Zyrtari i prokurimit duhet të bëjë çdo përpjekje të mundshme për të krijuar konkurencë të drejtë dhe të barabartë në mes operatorëve ekonomik dhe të siguroni OE se procesi është i hapur transparent dhe në përputhje me LPP

24. Neni 6 paragrafi 1 - Përkushtimi për standardet më të larta morale - zyrtari i prokurimit që udhëheq me procedura të prokurimit duhet të tregojë përkushtim për standardet më të larta morale duke parandaluar rrezikun që procesi i prokurimit të drejtohet te OE e parapëlqyer apo përpjekja për të ndërhyrë në procesin konkurues për ryshfet miqësi apo arsye tjera

25. Neni 7 paragrafi 1,2 dhe 3 - Marrëdhëniet me operatorët ekonomik - Të ju ofroni mundësi të barabarta të gjithë OE të kualifikuar apo para-kualifikuar për të konkurruar në aktivitetet e prokurimit duke garantuar paanshëmri për konkurencë të drejtë dhe të bëni përpjekje për të ruajtur marrëdhëniet positive dhe profesionale me të gjithë OE që mosmarrëveshjet të zgjidhen shpejt dhe drejtësisht

26. Pjesa C1: Deklarata nën betim për zyrtarët e prokurimit - Të udhëheqni procedurën e ekzaminimit,vlerësimit dhe krahasimit të tënderëvë në bazë të parimeve kryesore të procedurës së vlerësimit duke ju përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të LPP-së dhe rregullave të prokurimit publik - sipas Deklaratës nën Betim lidhur me dispozitat e përgjitshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrsve dhe dhënien e kontratave bazuar në Kapitullin IV-Udhëheqja e procedurave të prokurimit të LPP-sé

Andaj duke konsideruar se me vendimin e ankimuar AK ka vepruar në kundërshtim me aplikimin e dispozitave të lartshënuara të LPP-së dhe akteve nënligjore që si pasojë nga shkeljet e pretenduara ka rezultuar me dëmtimin e konzorciumit OE "El-Bau&Vemor" kërkojmë nga OSHP të shqyrtojë ankesën në bazë të dispozitave të specifikuara në pjesën e IX-të të LPP-së, dhe pas administrimit të provave dyuke bërë vlerësimin detal të të gjitha pretendimeve ankimore dhe duke ju dhënë peshë të gjitha fakteve të paraqitura në ankesë, i propozojmë të merr këtë

VENDIM

- **MIRATOHET** si e bazuar ankesa e OE "EL-BAU" me seli në Gjilan;

- **ANULOHET** Vendimi Nr. 02-13/30 i dt. 13.01.2017 mbi Refuzimin si të pabazuar të ankesës së OE "El-Bau",Letra standarde për tenderuesin e eliminuar, "El-Bau&Global Projekt", pranuar nga AK përmes postës elektronike me dt. 06.01.2017, Njoftimi për Dhënie të Kontratës OE "Zuka Company" është publikuar në ueb faqen e KRPP-së me dt. 06.01.2017 dhe vendoset që lënda të kthehet në RIVLERËSIM

- **DETYROHET** AK te merr masa adekuate korrigjuese për eliminimin e lëshimeve ligjore dhe të vendoset të shperblehet me kontrat OE "El-Bau"si ofertuesi i vetëm i pergjegjshem me çmimin më të ulët që ploteson te gjitha kriteret e kerkuara ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë;

- **REFUZOHET** çfarëdo kërkese e AK-së përheqjen e pezullimit të aktivitetit të prokurimi.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 13.12.2016

Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: .....Shërbime/vlerë e mesme

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 23.12.2016

Data e hapjes së ofertave .....23.12.2016-14:30^{h}

Kriter për dhënie të kontratës:.....*Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët*

Lloji i kontratës:.....*Kontratë kornize – 12 muaj*

Kriteret për vlerësim

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1)Kërkesat e përshtatshmërisë:

DOKUMENTET E KËRKUARA PËR PRANUESHMËRI:

1. Zotimin e OE se i plotëson kërkesat për të konkurruar sipas Ligjit 04/L-042, Neni 65
2. Dëshminë nga gjykata ekonomike se OE sipas nenit 65 të LPP.
3. Dëshminë se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Deklarata nën betim që tenderuesi i plotëson kërkesat për të konkurruar sipas Ligjit 04/L-042, Neni 65, **(e cila është pjesë e dosjes së tendserit) e nënshkruar dhe vulosur,**
2. Vërtetim nga gjykata ekonomike (jo me te vjetër se tre muaj) se OE nenit 65 të LPP - ***origjinal ose i noterizuar për kompanin e cila propozohet për shpërblim të kontratës***
3. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit (apo të ketë marrëveshtje me ATK për riprogramim të borgjeve).- ***origjinal ose i noterizuar për kompanin e cila propozohet për shpërblim të kontratës***

III.2.2)Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 1. Regjistrimisi operator ekonomiknëregjistrinprofesional, komercial dhe/aporegjistrin e ndërmarrjevenëvendin e juajtëthemelimit;
Kërkesa 2. Regjistrimii TVSH-s
Kërkesa 3. RegjistrimiiNumritfiskal

Dëshmia e kërkuardokumentare:
Dëshmi 1. Një document I lëshuar nga autoriteti përkatës public në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi I operatorite konomik në atë vend (Kopja e certificates së biznesit);
Dëshmi 2. Kopja e certificates sëTVSH-së; ose njearsyetim per mosperfshirja ne TVSH.
Dëshmi 3. Kopja e certificates së Numrit fiskal;

III.2.3)Kapaciteti ekonomik dhe financiar
N/A
Dëshmia e kërkuar dokumentare:
N/A

III.2.4)Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Kontrata të natyrës së ngjajshme të realizuara në tri vitet e fundit minimum tri kontrata.
2. Menagjer i projektit caktohet me shkresë (duhet të jetë ing.dip.ndërtimtarisë)
3. Një ing. I komunikacionit bachelar- një
4. Mekanizimi i nevojshëm për këtë lloj shërbimi

- Kamion transportues 4x4 me lugë dhe hedhëse të kripës tre copë
- Grejder një copë
- Bullduzher një copë
- Ngarkues një copë
- Kamionet picup një copë
- Eskavator një copë
- Cilindër vibrues një copë
- Hedhëse e borës – frezë një

Dëshmia e kërkuardokumentare:

1. Lista e kontratave të ngjajshme të realizuara në tri vitet e fundit minimum tri kontrata ku duhet të dëshmohet me raporte mbi pranimin e shërbimeve ose referenca për shërbime të ngjajshme ku qart duhet të ceket emri i projektit koha e realizimit të shërbimit vendi dhe vlera e projektit – **lista duhet të jetë e nënshkruar vulosur – origjinal.**
2. Menagjeri i projektit ing. Dip. Ndërtimtaris me 5 vite ose master **(diploma të jet e noterizuar, CV, kontrata)** duhet të caktohet me shkresë **– shkresa duhet me qen origjinale e nënshkruar dhe e vulosur.**
3. Një ing. I komunikacionit bachelar- një - **diploma të jete e noterizuar,CV,kontrata**

Lista e mekanizimit – ku kontraktori merr përgjegjësi për paisjet e ofruara. **Lista duhet me qen origjinale e nënshkruar dhe e vulosur. Librezat me afat regjistrimi, Ose nje marveshje per marrje me qira.**

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"El-Bau"	Gjilan	52,852.50€	JO
2.	"Zuka Company"	Gjilan	68,271.50€	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Xhelal Veseli - Kryetar i komisionit
- Driton Halabaku - Anëtar i komisionit
- Bejtush Qosa - Anëtar i komisionit.

Data e mbarimit të vlerësimit: 05.01.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....05.01.2017

Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e Krpp-së :.....06.01.2017

Sipas raportit të komisionit të vlerësimit ofertat të PËRGJEGJSHME janë:

Nr.	Emri i tenderuesit të Përgjegjshëm	Çmimi i ofruar	Radhitja sipas çmimit
1.	Zuka Company	68,271.50€	1

Raporti i komisionit vlerësues:
Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe Krahasimit te tenderëve, rekomandon për kontratë tenderim me ofertën e përgjegjshme me çmim me te ulet Company Zuka Comerce nga Gjilani.

Neni 54 i LPP-së – Njoftimi i kandidatëve - Tenderuesve

AK-ja, konform nenit 54 të LPP-së dhe nenit 37 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimit Publik, i njofton operatorët ekonomik me letrën standarde.

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Pas pranimit të letrës standarde OE ankues konform nenit 108/A ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, me ç'rast AK-ja, ja refuzon ankesën si të pa bazuar.

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

Sqarimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

- Nuk e ka plotësuar pikën 11.1 të FDT-së. AK-ja, në letrën standarde ka deklaruar se ju si OE jeni i papërgjegjshëm sipas njoftimit të datës: 30.12.2016, ku është tërhequr partneri – anëtari i konzorciumit OE "Global Project".

Eksperti shqyrtues, fillimisht sqaron se në këtë aktivitet të prokurimit OE ankues ka konkurruar si konzorcium, në përbërje prej: "El-Bau&Global Project".
Në vazhdim eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja, me datën: 23.12.2016 ka paraparë dorëzimin/hapjen e ofertave dhe pas hapjes së ofertave, me vendim AK-ja ka formuar komision për vlerësimin e ofertave.

Gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, konkretisht me datë: 30.12.2016, anëtari i konzorciumit OE "Global Project" i dërgon Komunës se Vitisë, Njoftimin për Tërheqje, në të cilin ndër të tjera thuhet:

"Ne tërhiqemi nga të gjitha obligimet tona dhe të gjitha detyrimeve në këtë tender, duke deklaruar dokumentet tona të pavlefshme dhe tërheqim autorizimin dhe mbështetjen tonë për partnerin lider në këtë konzorcium "El-Bau" Shpk nga Gjilani. Tërheqim të gjitha deklaratat tona, nënshkrimin, vulën, deklaratën nën betim, autorizimin për liderin dhe të gjitha autorizimet dhe dokumentet përcjellëse të dorëzuara për pjesëmarrje në këtë tenderim".

Sqarimi nr.2

Eksperti shqyrtues, sqaron se tërheqja e anëtarit te konzorciumit e bënë të papërgjegjshëm këtë grup të operatorëve ekonomik, për faktin se ky konzorcium nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit konkretisht pikës 11.1 të FDT-së dhe deklaratat e parapara në nenin 71 të LPP-së.
Në lidhje me këtë çështje, eksperti shqyrtues, sqaron se KRRP, tek pyetjet e shpeshta, numër 17, e ka publikuar interpretimin për rastet kur tërhiqet anëtari i konzorciumit në të cilin thuhet se i tërë grupi duhet të refuzohet dhe tenderi i tyre të eliminohet nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar edhe ne praktikat e mëhershme dhe interpretimet tjera te KRPP-se, për rastet e ngjashme është deklaruar se, bazuar në nenin 27 paragrafi 1 te Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, pika **c) ku thuhet se Anëtarët e grupit nënshkruajnë një deklaratë nga të gjithë për ta autorizuar partnerin udhëheqës të veprojë në emër të grupit**, nga kjo nënkuptohet se nëse ky konzorcium ushtron ndonjë ankesë ajo duhet të jetë e dorëzuar në emër të Konzorciumit dhe e nënshkruar nga partneri udhëheqës i autorizuar të veprojë në emër të grupit, e ne rastin konkret OE ankues "El-Bau", nuk ka me autorizim nga anëtari tjetër i konzorciumit OE "Global Project".

Prandaj, bazuar në sqarimin e dhënë eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, me të drejt e ka eliminuar OE ankues nga ky aktivitet i prokurimit dhe pretendimi i OE ankues për shkelje të dispozitave të LPP-së të cekura në ankesë janë të paqëndrueshme dhe se me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP, në asnjë rrethanë OE ankues nuk ka arritur të dëshmoj interes Juridik e Material konform nenit 4.1.26 dhe nenit 111 të LPP-së, për faktin se anëtari i konzorciumit i është tërhequr, siç u cek edhe më lart.

Sqarimi nr.3

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues në ankesën e parashtruar në OSHP, ne pjesën e deklaratës mbi fakte dhe argumente ka paraqitur disa pretendime tjera të cilat nuk janë kompetencë e OSHP-së që ti shqyrtoj.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – **Komuna e Vitisë (KV)**, për aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në territorin e Komunës së Vitisë"**, me numër të prokurimit: VI657/17/070/221, i ka respektuar dispozitat e LPP-së.
- Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ta aprovojë vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe njëherit i propozon PSH-së, që ankesa e OE ankues të hudhet poshtë si e palejuar.